



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:037278
Datë: 11.12.2024
Numri i dokumentit: 06583923

ARJ.nr.210/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Beshir Islami dhe Rustem Thaqi anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë në konflikt administrativ të propozuesit-paditësit, “ G.C.F G.C.F., SPA” - Dega në Kosovë, me seli në Rr. “....., Ç., P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, kundër kundërshtares së propozimit-të paditurës Dogana e Kosovës (DK), me seli në P., me bazë juridike anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/20790, të datës 16.01.2024, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të propozuesit-paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1497/24, të datës 28.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 06 Dhjetor 2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga propozuesi-paditësi “G.C.F G.C. F., SPA”-Dega në Kosovë, me seli në Rr. “.....”, ,,, P., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1497/24, të datës 28.08.2024.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1497/24, të datës 28.08.2024, I. APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana Kosovës, me seli në P., PRISHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.71/24 të datës 18.07.2024. II. HEDHET POSHTË kërkesa-propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues të paditurës nr.01.3.2/20790 të datës 16.01.2024, të parashtruar nga propozuesi-paditësi G.C.F G C. F., SPA-Dega në Kosovë, si e palejueshme.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së dytë, propozuesi-paditësi, “G.C.F G.C.F., SPA”-Dega në Kosovë, në afat ligjor në Gjykatën Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim që të APROVOHET në tërësi kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe të NDRYSHOHET aktvendimi i atakuar i Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1497/24 të datës 28.08.2024, ashtu që REFUZOHET ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë ndërsa aktvendimi i shkallës së parë KF.nr.71/24 të datës 18.07.2024 të VËRTETOHET, ose të APROVOHET kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET aktvendimi i atakuar i Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.577/24, të datës 07.03.2024, dhe lënda të i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosije.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit nuk ka ushtruar kundërshtarja e propozimit-e paditura.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së, mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të Dhomës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me vendimin e të paditurës Dogana e Kosovës 01.3.2.220790 të datës 16 janar 2024, është vendosur si në vijim: I. REFUZOHET - kërkesa e subjektit në procedurë “GCF G.C.F., SPA - Dega në Kosovë”, me numër unik identifikues, për rishqyrtimin e aktvendimit numër 03.1.1-2023-157 të datës 08.09.2023, të Sektorit të Kontrollës pas Importuese, si e pabazuar. II. MBETET NË FUQI – aktvendimi numër 03.1.1-2023-157 të datës 08.09.2023, i lëshuar nga Sektori i Kontrollës pas Importuese.

Kundër këtij vendimi propozuesi-paditësi ka parashtruar padi me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

Duke vepruar sipas kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, të propozuesit-paditësit, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me aktvendimin KF.nr.71/2024 të datës 07.02.2024, ka refuzuar propozimin-kërkesën e propozuesit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të aktit administrativ përfundimtar-vendimit me nr. 01.3.2.2/20790, datë 16.01.2024 të paditurës, Dogana e Kosovës, ndërsa është caktuar se procedura sipas padisë në këtë konflikt administrativ do të vazhdojë sipas rregullave të procedurës në konfliktin administrativ dhe sipas planit të punës së Gjykatës. Dhomat e Shkallës së Dytë, të kësaj gjykate me aktvendimin Kom.Dh.Sh.II.nr.577/24, të datës 07.03.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e propozuesit-paditësit ndërsa aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, po ashtu është konfirmuar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ.nr.76/2024 të datës 06.06.2024.

Propozuesi-paditësi me datë 15.07.2024, përsëri parashtron kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, me arsyetimin se nga të gjeturat dhe konstatimet e Gjykatës Supreme, si dhe për shkak të ndryshimit të rrethanave që kanë ndodhur tek propozuesi lidhur me gjendjen e tij financiare dhe me provat e reja, përmbushen në mënyrë kumulative kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

Duke vendosur sipas kërkesës së ripërsëritur të propozuesit-paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, me aktvendimin KF.nr.71/24 të datës 18.07.2024, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET si e bazuar propozimi-kërkesa e paditësit “G.C.F G.C.F., SPA”, me numër unik identifikues dhe seli në Rr/....., Ç., P., për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar – aktvendimit 01.3.2.2/20790 të datës 16 janar 2024, i nxjerr nga Dogana e Kosovës me seli në P.. II. SHTYHET ekzekutimi i aktvendimit 1.3.2.2/20790 të datës 16 janar 2024, i nxjerr nga Dogana e Kosovës me seli në P., deri në vendosjen e këtij kontesti tregtar - administrativ me vendim përfundimtar gjyqësor.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë arsyeton, ndër të tjera se: Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat propozuesi-i ka bashkëlidh kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit kontestues, erdhi në përfundim- se propozimi/kërkesa e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ-aktvendimit 01.3.2.2/20790, është e bazuar, për arsye se në rastin konkret ekziston rreziku real që pa shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi, paditësi do të mund të pësonte dëm të pa riparueshëm, në rast të mbledhjes së detyrueshme të borxhit doganor nga ana e të paditurës i cili është objekt i këtij kontesti tregtar administrativ. Andaj gjykata në kuptim të nenit 22 paragraf 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe nenit 27 paragraf 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kundërshtarja e propozimit-e paditura Dogana e Kosovës (DK), ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së dytë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, LKA-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që ankesa të aprovohet e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë KF.nr.71/2024 i datës 18.07.2024, të hedhet poshtë propozimi i propozuesit-paditësit, ose çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale në Prishtinë, në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur si në kuptim të nenit 49 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, e aprovon si të bazuar ankesën e të paditurës, prish aktvendimin e gjykatës së

shkallës së parë dhe e hedh poshtë si të palejueshme kërkesën e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës-kundërpropozueses. Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 lidhur me nenin 182 par. 2 pika (n) të LPK-së.

Në arsyetim të aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë ndër të tjera theksohet se: Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar sipas ankesës së ankuesit-paditurit, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 182 par.2 pika n) të LPK-së, dhe neni 22 të LKA-së kur ka aprovuar kërkesën e paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të paditurës Dogana e Kosovës, nr. 01.3.2.2/20790. Kolegji kësaj gjykate, ka gjetur se propozimi i tillë është i palejueshëm pasi gjykata e shkallës së parë për shkaqe dhe arsye të njëjta dhe ndaj vendimit të njëjtë, mes të njëjtave palëve ndërgjyqëse ka vendos tani me vendimin e Gjykatës Komerciale-Departamenti Fiskal K.DH.SHK.II nr.71/24 datë 07.02.2024 dhe i vërtetuar nga me Aktvendimin e shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale KF nr. 577/2024 datë 07.02.2024 dhe Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.nr.76/2024, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur asnjë rrethanat tjetër për të cilat do të vlerësoj gjykata, mirëpo për shkaqe të njëjta ndaj njëjtin vendim kërkon shtyrjen për të cilin tani më është vendosur me vendim të formës së prerë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate gjatë vlerësimit të Ri propozim të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, e hedhë poshtë kërkesën për shtyrje të ekzekutimit pasi që paditësi për të njëjtat arsye ka paraqit kërkesën për shtyrje të vendimit kontestues-vendimit të paditurës, Dogana e Kosovës, 01.3.2.2/20790, e ndaj vendimit të njëjtë tani me ekziston vendimi i formës se prerë i nxjerr ne konfliktin administrativ për të njëjtën çështje. Neni 34 i LKA-së par. 1 pika 1.6. parasheh se: *“ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerr në konfliktin administrativ, për të njëjtën çështje”*. Sipas vlerësimit të këtij kolegji, arsyetimi i aktvendimit të ankimuar është i mangët sa i përket fakteve vendimtare, sepse me vendimin e ankimuar nuk është arsyetuar fare kërkesa e ripërsëritur e paditësit për shtyrje të vendimit sipas kriterëve të lejueshmërisë së një kërkesë të tillë mbi bazë të cilës dispozitë ligjore është e lejuar një kërkesë e tillë, mirëpo ka vendosur njëjtë sikur të ishte kërkesa fillestare, duke mos dhënë arsye në arsyetimin e vendimit të ankimuar. Një ashtu edhe paditësi-propozuesi nuk e ka bazuar kërkesën e ripërsëritur në asnjë bazë ligjore në aspektin e lejueshmërisë së saj në raport me shkresa të lëndës. Andaj, në mbështetje të nenit 209 par.1 nën (b), neni 34 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

Kolegji i Gjykatës Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pas shqyrtimit të kërkesës së propozuesit-paditësit, vendimit të atakuar të Gjykatës Komerciale-dhomat e shkallës së dytë dhe dhomat e shkallës së parë gjen se: gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore në mbështetje të nenit 34 par.1 nënpar.1.6 të LKA-së, kur ka aprovuar ankesën të kundërshtares së propozimit-të paditurës Dogana e Kosovës, duke e prishur aktvendimin e dhomave të shkallës së parë dhe duke hedhur poshtë kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të

vendimit si të palejuar, sepse edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, lidhur me vendimin objekt kontesti nr. 01.3.2.2/20790 të datës 16.01.2024, të paditurës Dogana e Kosovës, ndërmjet palëve të njëjta ndërgjyqëse, dhe për shkaqe dhe arsye të njëjta është zhvilluar procedurë gjyqësore dhe është vendosur me aktvendim përfundimtar. Për kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, është vendosur me aktvendimin e dhomës së shkallës së parë të Gjykatës Komerciale KF.nr.71/24, të datës 07.02.2024, të vërtetuar nga dhomat e shkallës së dytë Kom.Dh.Sh.II.nr.577/24, të datës 07.03.2024, si dhe konfirmuar me aktvendimin e kësaj gjykate ARJ.nr.76/2024 të datës 06.06.2024, me të cilët është refuzuar propozimi i paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit përfundimtar të organit të paditur pasi që pretendimet e paditësit dhe faktet në të cilat thirret edhe tani sipas objektit të çështjes në shqyrtim nuk ishin bindëse për gjykatën që të miratohej kërkesa e tillë.

Pretendimet e theksuar si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera theksohet se: paditësi-propozuesi ka parashtruar kërkesën e re për shtyrjen të ekzekutimit të vendimit mbi të gjeturat dhe konstatimet e Gjykatës Supreme me aktvendimin ARJ.nr.76/2024 dhe në mbështetje të provave të reja, si dhe se masa e sigurisë mund të paraqitet në çdo rast dhe në secilën fazë para gjykatës, ngase asnjë dispozitë ligjore nuk e ndalon paraqitjen e propozimit të ri nëse ka prova të reja për ta mbështetur kërkesën e tij, kolegji i Gjykatës Supreme, këto pretendime i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson si të pa bazuara. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, respektimi i parimit të sigurisë juridike nga gjykata e instancave më të ulëta, është i domosdoshëm në një situatë të tillë juridike, në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën e prerë, ndërsa vendosja ndryshe krijon pasiguri juridike. Sipas nenit 22. 1 të LKA-së parashihet se padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ për veç kur parashihet ndryshe me ligj. Sipas kërkesës së palës në kuptim të paragraf 2, organi që ka nxjerrë apo gjykata si në kuptim të paragraf 6, të këtij neni, mund të shtyj ekzekutimin e vendimit të atakuar me padi, nëse vlerëson se palës i shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej. Për këtë çështje ashtu si u theksua më lartë gjykatat e instancave më të ulëta dhe Gjykata Supreme kishin vendosur , për deri sipas nenit 22 të LKA apo me ndonjë dispozite tjetër nuk parashihet në procedurë të konfliktit administrativ që pala mund të parashtror përsëri kërkesë të njëjtë për çështjen e njëjtë, të vendosur, me vendim përfundimtarë gjyqësor.

Gjithashtu aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë, nuk rezulton se është i përfshirë as me shkelje procedurale të dispozitave nga neni 182 par.2, pika (n) të LPK-së, ashtu si e thekson në kërkesë paditësi. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktvendimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjithashtu e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka ka vendosur gjykata e shkallës së dytë.

Numri i lëndës: 2024:037278

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06583923

Nga theksimet si më lartë dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi 1, i Ligjit për Konfliktet Administrative u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ nr.210/2024, me datë 06 Dhjetor 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani